

Treguesit e Shëndetit Publik


Viti, 2018

Tiranë, më 24 Korrik 2019: Në vitin 2018, numri i vizitave gjithsej në shërbimin parësor është 8.219.771, mesatarisht 3 kontakte për person në vit. Ky numër shënon një rritje prej 3,5 % krahasuar me numrin e vizitave gjatë vitit 2017. Ditët mesatare të qëndrimit të një pacienti në spital janë 5,5 ditë gjatë vitit 2018, nga 5,4 ditë që ishin në vitin 2017. Ndërhyrjet kirurgjikale në spitalet publike gjatë vitit 2018 janë 64.929 duke shënuar një rritje prej 13,0 %, krahasuar me vitin 2017.

I. Kujdesi shëndetësor parësor

Në vitin 2018, numërohen 413 qendra shëndetësore të degëzuara në 2.053 ambulanca, si dhe 46 poliklinika të specializuara.

Fig. 1 Numri i vizitave në qendrat shëndetësore, ambulanca dhe poliklinika



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vitin 2018, numri i vizitave në konsultorin e gruas është 243.594 nga të cilat 62,4 % janë realizuar me asistencë të mjekut specialist. Numri i vizitave të para obstetrikale është 29.517, i cili është në linjë me numrin e lindjeve të raportuara gjatë vitit 2018.

Tab. 1 Konsultori i Gruas

Emërtimi	Vitet				
	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i Konsultoreve	2.014	2.104	2.024	2.057	2.013
Numri i mjekëve në konsultor	715	739	762	765	728
Numri i mamive në konsultor	2.749	3.003	2.827	2.965	2.614
Numri i vizitave gjithsej	299.502	284.208	269.834	272.172	243.594
Numri i vizitave gjinekologjike	39.502	41.569	42.530	45.184	46.372
Numri i vizitave obstetrikale	260.000	242.639	227.304	226.993	197.222
- me mjek	161.152	156.631	147.044	141.717	124.994
Numri i vizitave të para obstetrikale	33.304	32.490	30.734	32.787	29.517

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në vitin 2018, numri i vizitave në konsultorin e fëmijëve është 802.633, ndër këto vizita 56,8 % janë ndjekur nga stafi i lartë mjekësor dhe pjesa tjetër janë ndjekur nga mami dhe infermierë.

Numri i fëmijëve 0 – 1 vjeç që ushqehen me gji gjatë viti 2018 është 18.988, ndërkohë numri i fëmijëve që ushqehen me ushqim artificial është 5.342.

Tab.2 Konsultori i Fëmijëve

Emërtimi	Vitet				
	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i konsultoreve të fëmijës	2.024	2.159	2.095	2.100	2.131
- Urban	176	149	154	158	167
- Rural	1.848	2.010	1.941	1.942	1.964
Numri i vizitave në konsultor	932.986	943.759	990.563	929.330	802.633
nga këto: sa nga mjeku	542.490	530.701	501.523	534.059	455.987
Nr. i fëmijëve të regjistruar në konsultor	278.646	254.174	259.354	286.092	253.403
Numri i fëmijëve që ushqehen me gji	24.729	22.382	20.928	20.702	18.988
Numri i fëmijëve me ushqim artificial	5.363	4.624	5.670	5.693	5.342

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mbulesa vaksinale është në nivelet mbi 98,0 % për shumicën e antigenëve vaksinal, duke përmbushur kështu dhe kriterin bazë ku çdo antigen vaksinal duhet të jetë mbi 95,0 % në nivel kombëtar. Në vitin 2018, vihet re një ulje prej 1,6 pikë përqindje në grupin e vaksinave Fruth-Rubeolë dhe Parotit për moshat mbi 1 vjeç.

Tab.3 Mbulimi vaksinal

Emërtimi	Vitet				
	2014	2015	2016	2017	2018
Fëmijë të vaksinuar për:					
– tuberkulozin	99,7	99,7	99,2	99,0	99,1
– difterinë	98,5	98,8	98,7	99,0	99,8
– tetanozin	98,5	98,8	98,7	99,0	99,8
– pertusin	98,5	98,8	98,7	99,0	99,8
– fruthin-rubeolë-parotit	97,6	97,8	96,3	95,7	94,1
– poliomitin	97,6	98,8	98,3	98,9	98,7

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

II. Shërbimi spitalor dytësor

Në vitin 2018, numri i spitaleve publik dhe jopublik në vend është 55, nga të cilët 42 janë spitale shtetërore dhe 13 spitale private. Mbulimi i shërbimit spitalor publik dhe jopublik është 2 spitale për 100 mijë banorë dhe numri i shtretërve spitalorë publik dhe jopublik është 8.868 (3 shtretër për 1.000 banorë).

Tab.4 Institucionet me Shtretër – Spitalet publike

Treguesit e aktivitetit	Spitale				
	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i institucioneve spitalore publike	42	42	42	42	42
Numri i shtretërve në total	8.295	8.224	8.172	8.169	8.185
Të shtruar në institucione	257.047	276.901	275.165	273.046	279.018
Ditë-shtretër të realizuar	1.497.809	1.549.208	1.470.515	1.444.336	1.528.499
Shfrytëzimi i shtratit në ditë	180,6	177,3	178,0	176,8	186,7
- në %	49,5	48,6	48,7	48,4	51,2
Ditë qëndrimi mesatar të sëmurit në spital	5,9	5,6	5,3	5,4	5,5
Xhiro e shtratit	31,0	31,6	33,6	32,8	33,8
Ndërhyrje kirurgjikale	62.393	51.470	52.248	57.475	64.929

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ditët e qëndrimit mesatar të një pacienti janë 5,5 ditë në vit me një xhiro të shtratit 33,8 herë pacientë në vit. Shfrytëzimi i shtratit për kujdes shëndetësor gjatë vitit 2018 është 186,7 ditë, të cilat përbëjnë 51,1 % të ditëve kalendarike të këtij viti.

Në vitin 2018, të shtruar gjithsej në institucionet e shërbimit spitalor ishin 279.018, nga të cilët 34,5 % janë realizuar pranë Q.S.U.T. Ndërhyrjet kirurgjikale në vitin 2018 ishin 64.929, nga të cilat 43,2 % e tyre u realizuan në Q.S.U.T.

Shërbimi për shëndetin mendor

Numri i shtretërve në shërbimin spitalor të specializuar për shëndetin mendor është 635. Ndërkohë në këtë shërbim spitalor të specializuar operojnë 25 mjek psikiatër.

Tab.5 Shërbimi spitalor/shëndeti mendor

Emërtimi	2015	2016	2017	2018
Numri i shtretërve spitalor	635	635	635	635
Mjek psikiatër	27	24	25	25
Infermier	177	168	169	172
Psikologë	14	15	15	16
Të tjerë	194	205	204	206

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Metodologji

Botimi mbi Treguesit e Shëndetit Publik përmban të dhëna mbi shërbimin e Kujdesit shëndetësor parësor dhe Shërbimit spitalor dytësor, me frekuencë vjetore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Të dhënat mbi shërbimin vaksinal kanë burim informacioni Institutin e Shëndetit Publik.

Përkufizime

Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor janë të gjitha institucionet shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët në mënyrë ambulante, të cilat janë të pajisura me të paktën një personel mjekësor mjek ose infermier (nuk përfshihet shërbimi i stomatologjisë).

Sëmundshmëria është numri i të gjitha rasteve të sëmundjeve në një popullsi, në një moment të dhënë (frekuenca e çastit) ose gjatë një periudhe të dhënë, pa dallim fillimin e sëmundjes dhe pa dallim ndërmjet rasteve të reja apo të vjetra.

Spitali është një rezidencë institucionale i pajisur për të ofruar kujdes mjekësor, hoteleri-24 orë, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve që mund të kenë nevojë për ndihmë mjekësore ose kirurgjikale.

Shtretër spitalorë janë shtretër për akomodimin e pacientëve të cilët janë pranuar formalisht në një institucion për trajtim ose kujdes dhe që qëndrojnë minimum një natë. Këtu përfshihen: shtretër në të gjitha spitalet, përfshirë spitalet e përgjithshme, spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit me substancat, spitalet e specialitetit, pavarësisht nëse krevati është i zënë apo jo.

Shfrytëzimi i shtratit në ditë është numri i ditëve mesatare të vitit gjatë të cilave një shtrat i spitalit është i zënë me pacientë.

Ditë shtretër të realizuar është shumëzimi i shfrytëzimit të shtratit në ditë me numrin e shtretërve në spital.

Shtrimet spitalore sipas gjinisë është raporti i numrit të pacientëve të dalë nga spitalet në një vit me numrin e popullsisë së atij viti të ndarë sipas gjinisë.

Xhiro e një shtrati është numri i të sëmurëve që janë shtruar në një shtrat gjatë vitit.

Shëndeti Mendor është një nivel i mirëqenies psikologjike. Është "gjendja psikologjike e dikujt që funksionon në një nivel të kënaqshëm në drejtim të përshtatjes emocionale dhe të sjelljes së përditshme".

Qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe shtëpitë e mbështetura ofrojnë shërbime ditore të specializuara kryesisht nga psikologë dhe janë të shtrirë në shtatë qarqe: Tiranë, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Korçë dhe Gramsh.